



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of
Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 06.07.2016,
e cila filloi në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së dhe Mirlinda Sopi shefe e GP të AKR-së.

Munguan: Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Mentor Zeka përfaqësues i OSBE-së dhe Lulzim Demolli.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Për këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS :

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm “Kalabria” në Prishtinë;
3. Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1” në Prishtinë;

4. Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Mati 2” në Prishtinë;
5. Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm “Sofalia” në Prishtinë 2016-2024;
6. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, të lagjes “Mati 1” në Prishtinë 2016-2024;
7. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës çeke;
8. Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve;
9. Të ndryshme.

Sami Hamiti kërkoi sqarime nga kryesuesi lidhur me pikat e Urbanizmit që janë në rishqyrtim, në mënyrë që të dihet se çka është ndërmarrë lidhur me këto pika që po i rishqyrtojmë këto vendime.

Halim Halimi, kryesues, dha sqarime, duke thënë se në mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës kemi marrë vendim për miratimin e planeve rregulluese të hollësishme “Sofalia”, “Mati 2” dhe “Kodra e Trimave”. Këto vendime i kemi dërguar në MAPL për konfirmim të ligjshmërisë, mirëpo nga Ministria na është kthyer përgjigje, se miratimi i tyre në Kuvend është i kundërligjshëm dhe na është thënë me shkrim se në afat brenda 30 ditësh, mundë t’i shqyrtojë dhe t’i paraqesim në Kuvend.

Ai u shprehu se mendimin se nuk do të duhej shqyrtuare këto plane pa u hartuar hartat zonale, pasi që na është thënë se janë në kundërshtim me ligjin. Njëherësh bëri të ditur se para caktimit të rendit të ditës, i është drejtuar MAPL-së me një shkresë të veçantë, për të marrë sugjerimin se cilat veprime konkrete duhet të ndërmerren nga ana e Komunës, në mënyrë që të qartësohet se çka mund të veprojmë ne, mirëpo nuk më është kthyer përgjigje.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Hamiti, theksoi se Zyra ligjore e Komunës së Prishtinës ka pasur disa takime me ministrinë përkatëse lidhur me këtë çështje, me Sektorin ligjor dhe me Sektorin e planifikimit, andaj kërkoj nga shefi i Zyrës ligjore, z. Olluri, të na informojë lidhur me rrjedhën e atyre takimeve dhe ta dimë se cili ka qenë vendimi i të dy palëve rreth kësaj teme.

Ai falënderoi kryesuesin që e ka dërguar shkresën në ministrinë përkatëse, që ka qenë hap i duhur, dhe besoj se do të na përgjigjen me shkrim.

Ardian Olluri njoftoi lidhur me takimet që kanë pasur me zyrtarët e Ministrisë dhe me dy sektorët, për shkresat e dërguar. Dilemën e cekur edhe ne e kemi paraqitur para tyre dhe kemi pyetur se a mund të procedojmë me këto plane, apo duhet me qenë të miratuara hartat zonale. Përgjigja e tyre ishte se këto që i keni të punuara, ligji i lejon me u bazuar në planet rregulluese të hollësishme, ose në planin zhvillimor komunal, ose në hartat zonale; këto që i keni punuar, pasi i lejon ligji, vazhdoni procedoni në Kuvend, vazhdoni me planin zhvillimor komunal dhe kur t’i hartoni hartat zonale, na tregoni dhe e kemi parasysh që këto që janë miratuar me u paraqitur në hartën zonale. I kemi bërë ndryshimet në vendime, i kemi vendimet e reja, dhe na është thënë gjithçka është në rregull.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se përmes Zyrës ligjore, jemi siguruar që t’i shohim vendimet që po i sjellim si rishqyrtim, se a janë në përputhje me gjetjet e tyre që i kanë dhënë në shkresën që i kanë trajtuar vendimet e Kuvendit. E kemi parë të arsyeshme, në diskutim edhe me kryesuesin, si ekzekutiv me proceduar më tutje, me shpresë me marrë përgjigje formale me shkrim nga Ministria.

Halim Halimi, kryesues, shprehu mendimin që të dërgohen në Kuvend, sepse në ndërkohë mund të marrim ndonjë shkresë tjetër, por është e habitshme se çfarë shkrese tjetër mundë të marrim jashtë këtyre shkresave që i kanë dërguar, kur hartat zonale nuk janë. Për këtë çështje jemi të interesuar të gjithë, pa dallim partiak. Synimi është që të procedojmë, të shkojmë më tutje, të punojmë sipas këtyre planeve, por unë u besoj shkresave të Ministrisë.

Qëndron Kastrati u shpreh se, siç e kuptuam nga kryesuesi, Ministria ka kërkuar që në afat prej 30 ditësh të rishikohen vendimet, mirëpo mendimi i kryesuesit është të mos trajtohen brenda 30 ditëve. Mendimi im është të vazhdojmë tutje, përderisa është sugjerim i Ministrisë që brenda 30 ditësh është afati kohor për t'i rishqyrtuar.

Sami Hamiti tha qoni në Kuvend këto pika ne i diskutojmë në Kuvend por ju lutem merrni atë interpretim, apsolutishtë nëse vjen interpretimi që janë të ligjshme kemi mi votua nëse nuk janë mos na shtini me votua diçka çka unë konsideroj se është e paligjshme dhe prapë do të vijmë në një situatë që ato materiale do të shkojnë e kthehen të paligjshme.

Qëndron Kastrati kërkoi që shkresat që kanë të bëjnë me çështjen e planifikimit të planeve të hollësishme rregulluese, t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Halim Halimi, kryesues, kërkoi nga Agimi që pas mbledhjes, t'u jepen të gjitha shkresat e MAPL-së anëtarëve.

Anëtarët e Komitetit u pajtuan me propozimin e Qëndronit, që të gjithë anëtarëve të Kuvendit tu përcillen këto shkresa.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, kërkoi nga sekretaria e Kuvendit që në procesverbal, krahas emrit të diskutuesit, çdoherë të shënohet edhe pozita ose funksioni për secilin diskutues.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm "Kalabria" në Prishtinë.

Pika e tretë

Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë.

Pika e katërt

Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes "Mati 2" në Prishtinë.

Pika e pestë

Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Sofalia" në Prishtinë 2016-2024.

Halim Halimi, kryesues, propozoi që të gjitha pikat e Urbanizmit të mos shkojnë veç e veç, të diskutohen në Kuvend.

Sami Hamiti u pajtua që në Kuvend të diskutohen, por kërkoi nga kryesues që të pritët një përgjigje më herët nga MAPL-ja, dhe kërkoi nga z. Olluri që komunikimin me Ministrinë ta bëjë vetëm përmes shkresave.

Halim Halimi, kryesues, bëri të ditur se shkresën e ka dërguar, por kur mund të kthehet përgjigja nuk e di. Ne do t'ua dërgojmë shkresën e Ministrisë që e kemi marrë para 12 ditësh, nëse na vjen shkresa për Kuvend, e sjellim, nëse na vjen edhe më herët, do t'ua dërgojmë menjëherë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që pika e dytë, pika e tretë, pika e katërt dhe pika e pestë të dërgohen në Kuvend për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, të lagjes "Mati 1" në Prishtinë 2016-2024;

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se kemi të bëjmë me Planin rregullues "Kodrina", ku është hera e parë që kemi 130 pronarë tokash private, që janë bërë bashkë për realizimin e një projekti të përbashkët banimi dhe social. Është negociuar koeficienti brenda PZHU-së, koeficienti lejon 3, është negociuar këtë rast që koeficienti të jetë 2.8, ku Komuna merr tokë për rrugë, shkolla, çerdhe dhe infrastrukturë sociale etj. Për këtë nevojiten të bëhen disa ndryshime në rrugë dhe infrastrukturë sociale. Nevojitet që Kuvendi ta shqyrtojë krejt projektin si Plan rregullues të hollësishëm, në përputhje me PZHU-në, dhe për këtë arsye është sjellë këtu para jush, në mënyrë që të procedohet në Kuvend për miratim.

Sami Hamiti shprehu mendimin se një memorandum që është i nënshkruar në mes të Kryetarit të Komunës, z. Shpend Ahmeti, dhe ndërmarrjes "Tregtia", është i paligjshëm. Çështja e negociimit të koeficientit në mes të Kryetarit dhe një kompani është krejtësisht e paligjshme.

Ai ceku se brenda sipërfaqes prej 21 ha, ka pronë të kombinuar, pronë shoqërore, komunale dhe private, andaj me këtë rast duhet pasur kujdes.

Lidhur me këtë sipërfaqe prej 21 ha, ai kërkoi të saktësohet se prona e kujt është.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se vetëm 130 prona trajtohen si prona private.

Qëndron Kastrati kërkoi të dijë se a është e vërtet që njëri nga anëtarët e Kuvendit të Komunës është bashkëpronar në këtë zonë, apo familja e tij, dhe të dihet se është apo nuk është konflikt interesi, mund të marrë apo nuk mund të marrë pjesë ai në votim.

Halim Halimi, kryesues, lidhur me pyetjen e z. Kastrati, u shpreh se nuk është i sigurt se ka apo nuk ka konflikt interesi në rastin konkret, por kjo mbetet të shihet.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: B 17, B 18, B 19 dhe B 20, të lagjes “Mati 1” në Prishtinë 2016-2024, me kërkesën e Samiut që të specifikohen 21 ha, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës çeke.

Dardan Sejdiu, nënkryetar, tha se është fjala për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës çeke. Ne jemi të interesuar që Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës çeke, të jetë pjesë e diskutimit dhe vendimit pozitiv të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe të ecim përpara me tema të tilla sa më shpejt dhe sa më mirë.

Halim Halimi, kryesues, tha se Ambasada çeke e ka bërë kërkesën për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, e jo ndarjen e pronës, është fjala për vazhdim, sepse, përndryshe, caktimi i hapësirave publike komunale për ambasada është çështje e Qeverisë. Qeveria është ajo që duhet t’i bëjë kërkesë Komunës për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqeve komunale.

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës çeke dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

**Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.**